



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK**

STUDIMET MASTER – E DREJTË CIVILE DHE PRONËSORE

Titulli i temës së diplomës:

“Gjyqvarësia dhe Kontestvarësia në Procedurën Civile”

Mentori:

Prof.dr. Iset Morina

Studenti:

Mirlinda Gajtani

Prishtinë / 2024

ABSTRAKT

Gjyqvarësia si institut juridik është pjesë e procedurës civile dhe që luan rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e momentit të fillimit të varësisë lidhur me procesin gjyqësor apo lidhjes së palëve me objektin e kontestit, ashtu që në mënyrë të qartë njoftohemi lidhur me pasojat materiale dhe ato formale me të cilat ky institut juridik na ndesh në praktikë.

Në anën tjetër një nga pasojat shumë të rëndësishme e që paraqet bazën ose parimin kyç të zhvillimit të procedurës ose procesit gjyqësor ndaj një subjekti, është parimi “Res Judicata” dhe “Ne bis in idem”. Me lindjen e gjyqvarësisë nuk mund të fillohet një proces i dytë gjyqësor lidhur me të njëjtin objekt ose kërkesëpadi, sepse vlen parimi i çështjes së gjykuar dhe nuk mund të gjykohet dy herë çështja e njëjtë. Më tej theksohet fakti se përveq gjyqvarësisë paraqitet edhe një fenomen tjetër procedural, jo domosdoshmërisht i pranishëm mirëpo me karakter fakultativ, e që është bashkëndërgjyqësia. Bashkëndërgjyqësia vie në shprehje me qëllim të mbrojtjes së parimit të efikasitetit, ekonomizimit, sigurisë juridike dhe duke mos lënë anash edhe parimin e barazisë së palëve, ashtu që secila palë që përbën terësinë e palëve bashkëndërgjyqëse gëzon të drejta dhe detyrime të njëjta brenda një procedure të tillë civile, edhe ndonëse veprimet e njëres palë mund të subsumohen ose të konsiderohen si veprim i kryer për të gjitha palët bashkëndërgjyqëse.

Gjyqvarësia ashtu sikurse krijohet apo paraqitet, e njëjta mund të shuhet apo përfundojnë raste të caktuara në procedurë civile. Shuarja e saj mund të vie si pasojë e veprimeve disponibile apo të vullnetshme të palëve, por edhe në bazë të vendimit gjyqësor, raste këto të sqaruara në pjesën përbërëse të këtij punimi.

Një e veçantë e këtij instituti juridik është mundësia e paraqitjes së tij, në rastet kur kemi të bëjmë me njohjen e vendimeve të huaja, konkretisht vendimeve me element të huaj, të cilat duhet të paraqiten pranë autoritetit kompetent për njohje dhe për ekzekutim. Kështu në përmbajtjen e këtij punimi do të flitet për rastet e paraqitjes së marrëdhënieve juridiko-civile me element të huaj, gjykimin e tyre pranë autoritetit kompetent dhe nxjerrjen e vendimeve të huaja nga organet kompetente jashtë Republikës së Kosovës, dhe rastet e propozimit nga palët me interes juridik që vendimet e tilla të njihen dhe të prodhojnë efekt juridik edhe në Republikën e Kosovës.

Një pjesë e trajtimit do të fokusohet edhe me vënien e analogjisë së paraqitjes së institutit juridik “gjyqvarësisë” edhe në procedurat e veçanta civile, përfshirë procedurën përmbarrimore dhe procedurën jokontestimore. Përveq saj, analogia iuris do të trajtohet edhe prezenca e këtij instituti juridik para tribunalit të arbitrazhit dhe vënia në dukje e zbatimit të saj praktik edhe në këtë tribunal, njëlloj sikurse para gjykatave shtetërore, mirëpo duke mos lënë anash edhe dallimet mes tyre dhe vazhdimin e ruajtjes së “monopolit” të gjykatës shtetërore në disa situata juridike.

I rëndësishëm është edhe fakti se në punim do të paraqiten edhe raste praktike/gjyqësore lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat kompetente lidhur me njohjen dhe me refuzimin e vendimit të huaj gjyqësor.

Në anën tjetër përveq nxjerrjes së vendimeve të huaja nga organet gjyqësore dhe propozimit për njohjen e tyre në Republikën e Kosovës, do të trajtohet edhe nxjerrja e vendimeve të huaja nga ana e arbitrazheve (gjykatave private) jashtë Kosovës, por edhe nxjerrja e një vendimi të huaj të tribunalit të arbitrazhit, kjo nga arbitrazhi kombëtar apo me seli në Kosovë, por palët e të cilit zgjedhin me marrëveshje dhe në mënyrë të vullnetshme, zbatimin e të drejtës formale të shtetit të huaj, dhe ashtu që më tej sqarohen edhe pasojat e shumta juridike të cilat shkaktohen në praktikë, si rezultat i zbatimit të së drejtës së huaj formale, në tribunale kombëtare të arbitrazhit.